



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.495/2022  
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores Nr. 03/2022 për procedurën e certifikimit, emërimit, kushtet, të drejtat, detyrimet dhe shpërblimin e ekspertëve gjyqësor, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Miratohet lista e kandidatëve të propozuar nga Komisioni për Vlerësimin e Kandidatëve për Ekspert Gjyqësor dhe të njëjtit pas përfundimit të obligimeve që rrjedhin nga Rregullorja Nr. 03/2022 certifikohen dhe emërohen si ekspert gjyqësor.
- II. Vendimi hyn në fuqi më 27 dhjetor 2022.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.252/2022, ka shpallur konkurs për certifikimin dhe emërimin e ekspertëve gjyqësor. Komisioni për Vlerësimin e Kandidatëve për Ekspert Gjyqësor, ka dorëzuar raport lidhur me procesin e certifikimit dhe emërimit të ekspertëve gjyqësor, ku të njëjtit pas përfundimit edhe të procedurave ankimore, propozojnë 1401 kandidatë për certifikim dhe emërim si ekspert gjyqësor. Lista me 1401 kandidatë përbëhet nga kandidatët për ekspert gjyqësor në mënyrë individuale dhe nga lista e institucioneve publike dhe të specializuara.

Këshilli, me datë 23 dhjetor 2022, pas shqyrtimit dhe analizimit të raportit nga Komisioni, miratoi listën e kandidatëve të cilët kanë plotësuar kushtet sipas Rregullores Nr. 03/2022, me ç'rast të njëjtit pas kryerjes së obligimeve që rrjedhin nga neni 10 i rregullores, certifikohen dhe emërohen ekspert gjyqësor.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.